

Leximet biblike



E hënë, 20 korrik 2020 – Leximet biblike

APOSTULLI – Jakovi 5:10-20

Merrni shembull, o vëllezër të mi, nga vuajtjet dhe durimi i profetëve, që folën në emrin e Zotit. Ja tek lumurojmë ata që durojnë. Keni dëgjuar për durimin e Jovit, edhe patë fundin prej Zotit, se Zoti është fort përdëllimtar dhe i dhembshur.

Edhe para së gjithash, o vëllezër të mi, mos u betoni, as për qiellin, as për dhenë, as ndonjë tjetër betim; po le të jetë po-ja juaj, po, dhe jo-ja, jo; që të mos bini në dënim.

Vuan ndonjë nga ju? Le të lutet. Gëzohet ndonjë? Le të psalë.

Është i sëmurë ndonjë ndër ju? Le të thërresë pleqtë e kishës, edhe le të luten për atë, e le ta lyejnë me vaj në emrin e Zotit. Edhe urata me besim do ta shpëtojë atë që lëngon, edhe Zoti do ta ngrerë atë; edhe në pastë bërë mëkate, do t'i falen. Rrëfejani fajet njëri-tjetrit, edhe lutuni për njëri-tjetrin, që të shëroheni.

Shumë fuqi ka lutja e të drejtit, kur bëhet me zjarr. Ilia ishte një njeri që pësonte si ne, edhe u lut duke u falur që të mos bjerë shi; edhe nuk ra shi mbi dhe tre vjet e

gjashtë muaj. Edhe përsëri u lut, edhe qielli dha shi, edhe dheu dha frytin e tij. O vëllezër, në daltë ndonjë nga ju jashtë udhës së të vërtetës, edhe ta kthejë ndonjë atë, le ta dijë se ai që kthen një mëkatar prej udhës së tij të gabuar, do të shpëtojë një shpirt nga vdekja, edhe do të mbulojë një shumicë mëkatesh.

* * * *

UNGJILLI – Llukai 4:22-30

Edhe të gjithë dëshmonin për të, dhe çuditëshin për fjalët e hirit që dilnin prej gojës së tij, dhe thoshin: A nuk është ky i biri i Josifit?

Edhe ai u tha atyre: Patjetër do të më thoni këtë proverb: Mjek, shëro veten tënde. Do me thënë, sa dëgjuam që janë bërë në Kapernaum, bëji edhe këtu në vendin tënd. Po ai tha: Me të vërtetë po ju them juve, se asnjë profet nuk është i pranuar në vendin e vet.

Edhe me të vërtetë po ju them juve, shumë të veja ishin në Izrael në ditët e Ilias kur u mbyll qielli tre vjet e gjashtë muaj, kur u bë një zi e madhe mbi gjithë dhenë. Po tek asnjë nga ato nuk u dërgua Ilija, përveç në Sareptë të Sidonës tek një grua e ve.

Edhe shumë lebrozë ishin në Izrael në kohën e profetit Elise; po asnjë nga ata nuk u pastrua, përveç Neman Sirianit.

Edhe të gjithë në sinagogë, kur dëgjuan këto, u mbushën me zemërim. Edhe u ngritën dhe e nxorën jashtë qytetit; edhe e prunë deri në buzë të malit, mbi të cilin ishte ndërtuar qyteti i tyre, që ta hidhnin poshtë. Po ai si kaloi përmes tyre, iku.

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë/facebook](#)